



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit për vetëqeverisjen lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 45, paragrafi 45.2 dhe 45.4 të Ligjit nr. 03/L - 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391 të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 08.06.2016, miratoi këtë

V E N D I M
P Ë R

MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ARKËTIMIN, SHPENZIMET DHE TË DHËNAT MBI INVESTIMET DHE DETYRIMET PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 31 MARS 2016

I.

Miratohet Raporti për arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet për periudhën 1 janar - 31 mars 2016 i propozuar nga Kryetari i Komunës.

II.

Raporti i cekur në pikën I të këtij vendimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 040-144713 , më 10.06.2016

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur i dipl.

